



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI  
VENDIM

Nr. 48, Datë 23.03.2022

**MBI**

**SHTYRJEN E VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-S PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “HERA” SH.P.K. PËR TRANSFERIMIN E PLOTË TË LICENCËS NR. 49, SERIA NPM07P, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT NR. 61, DATË 02.11.2007, “PËR NDËRTIM, INSTALIM, SHFRYTËZIMIN DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALE ME ERË (PROJEKTI KAPPET)”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2017; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.03.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 382/2-1 prot., datë 18.03.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizime dhe Mbikqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “HERA” sh.p.k., për transferimin e plotë të licencës nr. 49, Seria NPM07P, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, i ndryshuar”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 240, datë 02.12.2021, vendosi:
  1. Të fillojë procedurën për transferimin e plotë të licencës së shoqërsë “HERA” sh.p.k., me nr. 49, Seria NPM07P, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, me kapacitet të instaluar 150 MW, për një afat 30 vjeçar.
  2. Vendimi përfundimtar për transferimin e licencës së shoqërisë “HERA” sh.p.k. do të merret pasi Bordi i ERE-s të jetë shprehur në lidhje me shtyrjen ose jo të afateve të plotësisht të kushteve të vendimit nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar.
- Me email-in e datës 17.03.2022, në ERE kanë mbërritur: shkresa e protokolluar me tonën me nr. 65/5 prot., datë 18.03.2022, shkresa nr. 65/6 prot., datë 18.03.2022 dhe shkresa nr. 65/7 prot., datë 18.03.2022, të shoqërive “HERA” sh.p.k. dhe “SOT AL” sh.p.k. të cilat kanë vijuar me depozitimin e dokumentacionit shtesë që i është kërkuar nga ERE në lidhje me këtë praktikë.
- Me qëllim shqyrtimin e këtij dokumentacioni për të dalë më pas me propozimin përfundimtar në lidhje me kërkesën për transferimin e licencës së shoqërisë “HERA” sh.p.k. të shoqëria “SOT AL” sh.p.k. vleresojmë shtyrjen me 30 ditë pune të afatit të

vendimmarrjes finale të bordit të ERE-s, në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” në lidhje me këtë kërkesë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimarrjen e bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërsë “HERA” sh.p.k., për transferimin e licencës nr. 49, Seria NPM07P, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**